



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2019:130219

Datë: 12.10.2020

Numri i dokumentit: 01180731

C.nr.1212/18

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.A. nga Fshati ..... Komuna Prizren, kundër të paditurve M.R. nga ..... të cilin e përfaqëson me autorizim av.Gazmend Rexhepi, Z.Z. dhe B.Z. nga ....., baza e kontestit vërtetimin e pronësisë së lokaleve, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në prani të paditësve dhe të paditurve si dhe përfaqësuesi i të paditurit M.R. av. Gazmend Rexhepi, me dt. 03 Shtator 2020 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit A.A. nga fshati ..... Komuna Prizeren kundër të paditurit M.R. nga fshati ..... Komuna Prizeren, Z.Z. dhe B.Z. nga ....., për vërtetim pronësie, **si e bazuar**.

**II.VËRTETOHET** se paditësi A.A. nga fshati ..... K.Prizren, sipas bazës së posedimit me mirëbesim është pronar i pronësisë së paluajtshme dhe atë lokaleve të evidentuara sipas fletësposeduese ngastrave kadastrale dhe atë parcelave:

0-72809093-01667-1-2-39-0 në sipërfaqe prej 35 m<sup>2</sup>,

0-72809093-01667-1-2-40-0 në sipërfaqe prej 23 m<sup>2</sup>,

0-72809093-01667-1-2-41-0 në sipërfaqe prej 23 m<sup>2</sup>,

0-72809093-01667-1-2-42-0 në sipërfaqe prej 12 m<sup>2</sup>,

**III.OBLIGOHEN** të paditurit M.R. tani me adresë ....., Sërbi, dhe të paditurit Z.Z. dhe B.Z. nga ....., që t'ia pranoj dhe t'ia lejoj paditësit A.A. nga fshati ..... K.Prizren që paluajtshmëritë e cekur në piken **II** të dispozitivit, të regjistroj- bart në emër të tij si pronar, brenda afatit prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim pas plotfuqishmërisë do ti shërbej paditësit për bartjen e pronësisë në drejtorin për pronë gjeodezi dhe kadastër në Komunën e Shtimës pa prezencën e të paditurve.

## A r s y e t i m

Paditësi A.A. nga fshati ..... Komuna Prizeren me datë 11.12.2018 ka ushtruar padi kundër të paditurit M.R. pronar i ndërmarrjes '.....' në ..... Serbi, ndërsa në seancën e datës 09.07.2020 e ka zgjeruar padinë edhe ndaj të paditurve Z.Z. dhe B.Z., për vërtetim pronësie me të cilën ka kërkuar që i padituri t'i bëjë bartjen e pronësisë së lokaleve afariste të cilat gjenden në Shtime.

I autorizuari i të paditurit të parë av.Gazmend Rexhepi ka deklaruar se mbetet pranë përgjigjes në padi duke deklaruar se nuk e kundërshton padinë pasi paditësi këto lokale i ka në posedim që nga koha kur i ka blerë, çmimin e ka paguar në tërësi, i njëjti ka kërkuar nga gjykata që të sjell aktgjykim duke u bazuar në administrimin e provave.

Të paditurit Z.Z., B.Z. kanë mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, të njëjtit gjykatës i kanë propozuar që të merr aktgjykim në bazë të pohimit, pasi nuk e kanë kundërshtuar faktin se lokalet kontestuese i ka blerë paditësi dhe se i njëjti e ka paguar çmimin në tersi, kanë deklaruar se babai i tyre ka vdekur dhe ne trashëgimtar ligjor janë shpallur ata dy dhe i kanë dorëzuar gjykatës vendimin me të cili janë shpallur trashëgimtar ligjor të S.Z..

Gjykata për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore në procedurën e provave bëri administrimin e këtyre provave: *padia C.nr.1212/18 dt. 11.12.2018, Kontrat me nr. 647/96-PR datë 15.11.1996, Lexohet certifikata e pronësisë në emër Gragjevinar, Kopja e Planit, Përgjigje në padi dt.11.03.2019, Raport plotësues nga gjeometri R.U.dt.10.08.2020, Aktvendim nga komuna e Shtimes nr.143/40/2018, Skicat e planit të lokaleve, Certifikatë e pronësisë, Kontratë me nr.570/96 dt.16.10.1996, Kontratë 579/96 dt.16.10.1996*

Pas vërtetimit të provave një nga një në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të kujdesshme e të gjitha së bashku konform nenit 8 të LPK-së, deklarimeve të autorizuarve të palëve, gjykata gjeti dhe vendosi siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe vërtetoi këtë gjendje faktike:

Nuk është kontestuese se paditësi e kishte blerë pronën me 12.01.1986, pasi një gjë e tillë vërtetohet në bazë të Kontratës në gjuhën serbe (Ugovor) 12.01.1986, kontratë jo formale e lidhur në mes paditësit dhe të paditurit për blerje të paluajtshmërisë.

Nuk është kontestuese fakti se paditësi është pronar i lokaleve afariste të cilat gjenden në Shtime, konkretisht në qendrën tregtare për ballë Komunës së Shtimes të cilat ika blerë në vitin 1996 dhe atë lokalit me nr.19 dhe 20 me sip. 45.76 m<sup>2</sup> i ka blerë nga ndërmarrja ndërtimore ..... me pronar M.R., kurse lokalit me nr.1 në sipërfaqe prej 11.94 m<sup>2</sup> e ka blerë nga Z.Z., ndërsa lokalit me nr.18 në sipërfaqe prej 34.92 m<sup>2</sup> e ka blerë nga B. dhe S.Z..

Nga aktvendimi në gjuhën serbe me nr.O.br.11/2010 vërtetohet se trashëgimtar të S.Z. pas vdekjes së të njëjtit janë shpallur trashëgimtarët e tij ligjor- djemtë B. dhe Z.Z..

Nga vërtetimi i këtillë i gjendjes faktike si dhe nga vetë deklarata e dëshmitarëve si dhe palës paditëse, gjykata ka ardhur në përfundim se paditësi A.A. në bazë të të gjithë provave të vërtetuara në shqyrtimin kryesor, është bërë pronar legjitim i kësaj patundshmërie në bazë të blerjes dhe mbajtjes si dhe duke u bazuar në nenin 28 paragrafi 4 të LMTHJP, në të cilin është përcaktuar se “ *Personi i cili me mirëbesim e ka njëzet (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmërie ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të*”, andaj në rastin konkret paditësi e ka fituar të drejtën në ngastrat kontestuese me parashkrim fitues e cila gjë vërtetohet me faktin se paditësi këtë patundshmëri e kanë mbajtur me mirëbesim që nga vitet e 90-ta, dhe këtë të paditurit asnjëherë nuk e kanë kontestuar.

Gjykata e aplikoi Ligjin e Vjetër pasi baza juridike ka lindur apo është krijuar në kohën kur në fuqi ka qenë ligji i vjetër Ligji nr. 827 i datës 30.01.1980 mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore, ashtu që aplikoi nenet 7, 9 par. 2, 19, 20 dhe 33 të këtij ligji. Gjithashtu edhe Ligji mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, ligji nr.03/L-154 e rregullon në të njëjtën mënyrë fitimin e pronësisë në paluajtshmëri me veprim juridik, e atë në nenet 10, 36, 57 dhe 115.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mbështeti në nenin.452.4 të LPK-së andaj ka vendosur qe secila nga palët ti bartë shpenzimet e veta procedurale, pasi asnjëra nga palët nuk i ka kërkuar shpenzimet.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.1212/18 datë 2 tetor 2020

**Gj y q t a r j a**  
Mirlinda Bytyqi Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.